



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 35

2001

Qershor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.8784 datë 7.5.2001	Për ratifikimin e “Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Kanadasë për ndërtimin e vendqëndrimit të ri të avionëve civilë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit”..... 1077
Ligj nr.8800 datë 17.5.2001	Për ratifikimin e “Amendamentit të Marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Islamike të zhvillimit për projektin e furnizimit të fshatrave me ujë të pijshëm”..... 1087
Ligj nr.8801 datë 17.5.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë me “ELBER” sh.p.k. dhe KfW për projektin dhe huanë për Ndërmarrjen e Ujësjellës-kanalizimeve në Elbasan”... 1091

Ligj nr.8802 datë 17.5.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes No.Aba-R1-2-D për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga marrëveshja e huasë No.Aba-P1 e datës 28 nëntor 1995 ndërmjet Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar”.....	1098
Ligj nr.8803 datë 17.5.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes No.Aba-R1-1-D për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga marrëveshja e Huasë No.Aba-C1 e datës 11 maj 1994 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar”.....	1102
Ligj nr.8804 datë 17.5.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës kombëtare Elbasan-Librazhd”.....	1106

L I G J
Nr.8784, datë 7.5.2001

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË
SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KANADASË PËR NDËRTIMIN E
VENDQËNDRIMIT TË RI TË AVIONËVE CIVILË NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR
TË RINASIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Kanadasë për ndërtimin e vendqëndrimit të ri të avionëve civilë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3012, datë 18.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET QEVERISË SË KANADASË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
LIDHUR ME NDËRTIMIN E VENDQËNDRIMIT TË RI TË AVIONËVE CIVILË
NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RINASIT

Qeveria Kanadeze e quajtur “KANADA” dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë e quajtur “SHQIPËRIA”, duke dashur të bashkëpunojnë për vënien në jetë të projektit KANADEZ të asistencës në Shqipëri, kanë arritur mirëkuptimin (marrëveshjen) e mëposhtme:

Neni 1

Natyra e Memorandumit të Mirëkuptimit

Paragrafi 1.01

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk përbën një traktat ndërkombëtar. Ai ka si qëllim të caktojë përgjegjësitë KANADEZE dhe SHQIPTARE në lidhje me Projektin e përshkruar në nenin 3.

Neni 2
Autoritetet përgjegjëse

Paragrafi 2.01

KANADAJA emëron Agjencinë Ndërkombëtare Kanadeze të Zhvillimit (e quajtur “CIDA”) të marrë përsipër përgjegjësitë e saj sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Drejtuesi i Departamentit Kanadez të Mbrojtjes Kombëtare do të jetë Menaxher i Projektit në emër të Shqipërisë dhe Kanadasë.

Paragrafi 2.02

SHQIPËRIA emëron Ministrinë e Transportit (e quajtur “MOT”) , përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil të marrë përsipër në vazhdimësi ndërlidhjen dhe përgjegjësitë përkatëse në emër të Shqipërisë, gjatë zbatimit të projektit të përshkruar në nenin 3.

Neni 3
Projekti

Paragrafi 3.01

Kanadaja dhe Shqipëria do të marrin pjesë në implementimin e projektit (i quajtur “Projekt”). Qëllimi i këtij Projekti është të ndërtojë një vendqëndrim të ri për avionët civilë në Aeroportin e Rinasit, sipas përshkrimit të bërë në Projektplanin e Menaxhimit në Aneksin “A”.

Paragrafi 3.02

Projekti është përshkruar në anekset “A”, “B”, dhe “C” të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 4
Plani i Menaxhimit

Paragrafi 4.01

Për qëllimin e implementimit të Projektit, KANADAJA dhe SHQIPËRIA, do të zhvillojnë një Plan Menaxhimi i cili do të përbëjë një dokument operimi midis CIDA/DND dhe DGA/MOT. Plani i Menaxhimit do të kompletohet dhe nënshkruhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, dhe kur të nënshkruhet në kohën e duhur në emër të KANADASË dhe SHQIPËRISË, do të bashkëngjitet si Aneksi “A” dhe do të përmbajë midis të tjerave:

- një përshkrim të detajuar të projektit;
- një skicë të metodave dhe ideve që do të përdoren për implementimit e Projektit;
- një kalendar për implementimin e aktiviteteve të projektit, përfshirë dhe buletin historik;
- raportimin e kërkesave të projektit;
- natyrën, kohëzgjatjen dhe përgjegjësitë për vlerësimet e Projektit dhe mjetet për arritjen e tyre;

- burimet e kërkuara për projektin; dhe
- një deklaratë të detyrimeve shtesë, detyrat dhe përgjegjësitë e KANADASË dhe SHQIPËRISË, së bashku me kontributet e tyre.

Plani i menaxhimit mund të përmirësohet me një mirëkuptim të përbashkët prej DND dhe Drejtorit të Aeroportit të Rinasit, pa ndjekur procedurat formale të përmirësimit.

Neni 5
Kontributi i Kanadasë

Paragrafi 5.01

Kontributi i KANADASË, do konsistojë në sigurimin e asistencës teknike për implementimin e projektit. Vlera totale e kontributit kanadez nuk do t'i kalojë 2.1 milion USD kanadezë. Kontributi i Kanadasë përshkruhet në Aneksat "A" dhe "B" të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Paragrafi 5.02

Të ardhurat e kontributit kanadez nuk do të përdoren nga projekti për të paguar taksë tatimet apo taksat doganore, VAT ose ndonjë taksë apo detyrim tjetër, ngarkuar direkt ose indirekt nga Shqipëria në mallrat, materialet, pajisjet, kamionët ose shërbimet e paguara ose të pranuar për të përballuar kërkesat e projektit ose në lidhje me implementimin e projektit.

Neni 6
Kontributi i Shqipërisë

Paragrafi 6.01

Kontributi i Shqipërisë është përshkruar në Aneksat "A" dhe "C" dhe do të konsistojë në sigurimin e kushteve të nevojshme për implementimin e projektit dhe kontribute të tjera të nevojshme për të përballuar kërkesat e projektit.

Paragrafi 6.02

Shqipëria do të sigurojë në kohë lejet për të ndërmarrë projektin, duke përfshirë lejet e ndërtimit.

Neni 7
Përcaktimi i firmës Kanadeze dhe personeli

Paragrafi 7.01

Për qëllim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi:

"Firmë Kanadeze" nënkupton Departamentin Nacional të Mbrojtjes Kanadeze, lidhur me projektin, i cili është formuar sipas ligjeve kanadeze.

"Personel Kanadez" nënkupton kanadez ose shtetas të tjerë ndryshe nga shqiptarë ose qytetarë me qëndrim jo të përhershëm në Shqipëri, të cilët punojnë për projektin në Shqipëri.

"Persona në varësi" nënkupton:

- a) personin e regjistruar si bashkëshort (e) i një anëtari kanadez të personelit;
- b) një fëmijë i një anëtari kanadez të personelit ose bashkëshorti (ja) e tij që është nën 21 vjeç dhe në varësi të anëtarit kanadez të personelit ose bashkëshorti (ja) e tij për mbështetje për arsye të paaftësisë fizike ose mendore.

Neni 8
Dëmshpërblimi

Paragrafi 8.01

SHQIPËRIA do dëmshpërblejë dhe do ruajë të pa cenuar KANADANË, DND, personelin kanadez të punësuar nga projekti për përgjegjësi civile, për aktet e lënies në dorë të shfaqura gjatë përmbushjes së detyrës në implementimin e projektit përveç akteve të ngritura nga neglizhenca e madhe ose sjellja e keqe me dashje e DND ose personelit Kanadez.

Paragrafi 8. 02

Anëtarët e forcave kanadeze dhe personeli i Departamentit Kanadez të Mbrojtjes Nacionale që veprojnë në implementimin e këtij MOU do jenë subjekt i parashikimeve të Nenit 8 të Marrëveshjes midis Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, lidhur me statusin e forcave të tyre të datës 19 qershor 1951 (NATO SOFA) si e përfshirë nga marrëveshja midis shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe të Shteteve të tjera që marin pjesë në Partneritetin për Paqe, duke patur parasysh statusin e forcave të tyre datë 19 qershor (PfP SOFA)

Neni 9

Taksa dhe përjashtimet e tjera

Paragrafi 9.01

Statusi i anëtarëve të forcave Kanadeze dhe të departamentit Kanadez të Mbrojtjes Nacionale, të përfshira në implementimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi në Shqipëri, do të jetë në përputhje me klauzolat e (NATO SOFA) si e përfshirë në PfP SOFA.

Paragrafi 9. 02

SHQIPËRIA do të përjashtojë tërë personelin Kanadez dhe familjarët e varur prej tyre në projekt prej të gjitha taksave personale lokale, VAT dhe tatimeve, duke përfshirë taksa për personin për udhëtimet jashtë vendit, si dhe taksën mbi të ardhurat, me kusht që të ardhurat e siguruara të dalin jashtë SHQIPËRISË ose nga fondet e ndihmës Kanadeze, siç parashikohet në këtë Memorandum Mirëkuptimi. Përveç kësaj, SHQIPËRIA do të përjashtojë gjithë personelin Kanadez prej çdo obligimi të bërë prezent me deklarata me shkrim në lidhje me këto përjashtime .

Paragrafi 9.03

Shqipëria do të përjashtojë DND dhe personelin Kanadez nga taksat e importit, tarifa doganore, VAT dhe llojet e tjera të taksave, detyrimeve ose taksave për pajisjet teknike profesionale për përdorim në Projekt nga Personeli Kanadez ose personave të emëruar nga KANADAJA dhe DND, me kusht që ky përjashtim nga taksat tarifit, detyrimet ose tatimet do të aplikohet në mallrat ose pajisjet e siguruara në vend dhe jashtë Shqipërisë. Kjo përfshin për shembull, blerjen e çimentos, shkëmbinjtë të thërmuar, zhavorrit etj.

Paragrafi 9. 04

SHQIPËRIA do të përjashtojë personelin Kanadez dhe familjarët e tyre që nga ardhja e tyre në Shqipëri nga taksat doganore e tjera, VAT, tatimet dhe detyrimet e tjera të ngjashme në pajisjet personale dhe mjetet, subjekt të rieksporimit ose të mbarimit të periudhës së përdorimit të pajisjeve të tilla ose të atyre pajisjeve në fjalë që janë në dispozicion të personave që gëzojnë këto këto përjashtime. Në rastet e zjarrit ose të vjedhjes, ky përjashtim mund të ribëhet në çdo moment gjatë caktimit të personelit Kanadez.

Paragrafi 9. 05

Fondet, pajisjet, produktet, materialet dhe të mirat e tjera të siguruara për implementimin e Projektit nuk do të jenë subjekt të çdo lloj takse, duke përfshirë VAT, taksat e importit, tarifit doganore, taksat e inspektimit ose detyrimet që kanë të bëjnë me magazinimin ose tatimet, taksat apo detyrimet e tjera.

Paragrafi 9. 06

Shqipëria do t'i garantojë personelit Kanadez dhe familjarëve të tyre liri nga kufizimet e shkëmbimit të monedhave në lidhje me rieksporimin e rrogave të tyre, shpërblimeve ose të të ardhurave të tjera transferuar nga jashtë përmes bankave të autorizuar në SHQIPËRI.

Paragrafi 9.07

Me kërkesë Shqipëria do të informojë DND dhe personelin Kanadez për ligjet lokale dhe rregullat të cilat mund të kenë lidhje me ta gjatë kryerjes së detyrës së tyre.

Paragrafi 9.08

SHQIPËRIA do të ndihmojë në riatdhesimin e personelit Kanadez dhe familjarëve të tyre në rastet kur, në opinionin e KANADASË OSE SHQIPËRISË , jeta ose siguria e personave Kanadezë është në rrezik.

Paragrafi 9.09

SHQIPËRIA do t'i sigurojë tërë personelit Kanadez dhe familjarëve të tyre viza me shumë hyrje-dalje për udhëtim, por edhe nga Shqipëria dhe do të jetë përgjegjëse të sigurojë certifikatat e sigurisë, lejet dhe dokumentet e tjera të ngjashme për DND për implementimin me sukses të projektit.

Paragrafi 9.10

SHQIPËRIA do t'u sigurojë përfaqësuesve të personelit të CIDA dhe personelit Kanadez të gjitha lehtësirat e nevojshme të vizitojnë çdo vend në Shqipëri për aktivitete zyrtare që lidhen me projektin.

Neni 10

Informacion

Paragrafi 10.01

KANADAJA dhe SHQIPËRIA do të sigurojnë që ky Memorandum Mirëkuptimi të implementohet me zellin e duhur dhe efikasitet, dhe do t'i japin tjetrës informacione që kanë të bëjnë me projektin siç është e arsyeshme të bëhet.

Neni 11

Komunikimet

Paragrafi 11.01

Çdo komunikim ose dokument i dhënë, i bërë ose i dërguar nga KANADAJA ose SHQIPËRIA në zbatim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi , do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme :

For CANADA : The Program Manager RZE
Central and Eastern Europe

Canadian International Development Agency

200Promenade du Portage

Hull , Quebec

KIA OG4

Facsimile : 994-3669

For ALBANIA : Directorate of Civil Aviation

Rr " Durrësit " No 202

Tirana , Albania

Facsimile :3554226232/23969

Paragrafi 11.02

KANADAJA ose SHQIPËRIA, me anë të një njoftimi me shkrim të adresës, mund të ndryshojnë adresën në të cilën dorëzohen të gjithë dokumentet ose komunikimet.

Paragrafi 11.03

Të gjithë dokumentet dhe komunikimet për KANADANË do të jenë në gjuhën angleze ose frënge , dhe të gjitha dokumentet dhe komunikimet për SHQIPËRINË do të jenë në gjuhën angleze

ose frënge.

Neni 12
Konsultimet

Paragrafi 12. 01

KANADAJA dhe SHQIPËRIA do të konsultohen ndërmjet tyre për çdo problem që mund të dalë në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Neni 13
Aplikimi

Paragrafi 13. 01

Ndryshimet që mund të dalin në aplikimin e parapërgatitjes së këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të përcaktohen me negociata midis KANADASË dhe SHQIPËRISË , me ndonjë mënyrë tjetër të rënë dakord reciprokisht.

Paragrafi 14. 01

Ky Memorandum Mirëkuptimi së bashku me anekset “A” “B” dhe “C”, ku secila është një pjesë integrale, formojnë Memorandumin e plotë midis KANADASË dhe SHQIPËRISË sipas Projektit.

Paragrafi 14.02

Memorandumi i Mirëkuptimit mund të përmirësohet nëse mund të shihet e nevojshme nga KANADAJA dhe SHQIPËRIA , përmes shkëmbimit të letrave.

Paragrafi 14. 03

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi dhe do të ketë veprim ditën e nënshkrimit dhe do të mbesë kështu deri më 31 dhjetor 2001.

Për Qeverinë Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë Kanadeze

ANEKSI “A”

**PROJEKTI PËR NDËRTIMIN E VENDQËNDRIMIT TË RI TË AVIONËVE CIVILË
NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RINASIT, PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE**

SFONDI

Shqipëria ka mbajtur peshën kryesore të krizës së refugjatëve kosovarë. Megjithatë vendi më i varfër në Europë ajo mirëpriti mbi 400 000 shqipëtarë të Kosovës , gjë e cila solli një shtrëngim të veçantë të financave të saj publike dhe kufizoi strukturën e saj. Vështirësitë ekonomike të Shqipërisë kanë qenë një kompleks i përçarjes së tregëtisë rajonale të transportit dhe investimeve .

Me përfundimin e konfliktit , një nga vendet e para të identifikuar për aksionin ndërkombëtar është rehabilitimi i rrugëve lidhëse dhe i vendqëndrimit në Aeroportin e Rinasit.

Aeroporti i Rinasit lokalizohet afërsisht 25 km nga Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë. është i vetmi Aeroport Ndërkombëtar në Shqipëri dhe zhvillimi i tij është cilësi për një zhvillim ekonomik të vendit.

Aeroporti i Rinasit gjatë krizës së Kosovës nuk ishte vetëm aeroporti i parë për ndihmë humanitare, por ishte gjithashtu baza kryesore për forcat e NATO – AFOR. Pista, së bashku me rrugët lidhëse dhe vendqëndrimin u dëmtuan nga numri i madh dhe madhësia e aeroplanëve që përdorën aeroportin. NATO ka rënë dakord që të riparojë dëmtimin që iu atribua përdorimit nga forcat e saj të aeroportit . CIDA do të mbështesë ndërtimin e vendqëndrimit të ri të avionëve civilë sipas

standardeve të plota ndërkombëtare. Departamenti Kanadez i Mbrojtjes Nacionale shprehu një interes në pjesëmarrjen në këtë iniciativë dhe mori përsipër misionin e pajtimit në gusht 2000. Departamenti i Mbrojtjes Nacionale (DND) ka rënë dakord të skicoje dhe të mbikqyrë ekzekutimin e projektit, i cili do të realizohet përmes kontraktorëve konkurrues lokalë të zgjedhur.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti i propozuar përfshin ndërtimin e 80m x 150m vendqëndrimi shtesë . Ky zhvillim përputhet me planin e Qeverisë Shqiptare për zhvillimin afatgjatë të aeroportit.

Kalendari i propozuar i zbatimit :

- Skicimi dhe parapregatitjet specifike 3 muaj
- Skicimi pasqyra specifike dhe aprovimet 1 muaj
- Tenderi i Projektit 2 muaj
- Ndërtimi 3 muaj
- Raporti final 3 muaj

Një grup prej pesë personash është i nevojshëm për 6 muaj (për fazën e tenderimit dhe ndërtimit).

Prokurimi : Për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik në Shqipëri, të gjithë materialet e ndërtimit për projektin do të nevojiten të importohen. Gjithashtu, kjo nuk mban parasysh probleme teknike përveç rrezikun që kalendari i ngjeshur i zbatimit të projektit është real, prandaj mund të kërkojë një afat tjetër ekstra.

Mjedisi : Në përputhje me Aktin Kanadez të vlerësimit të ambientit, CIDA ka drejtuar një ekranizim të ambientit të territorit të Aeroportit. Nuk pritet të ndodhë ndonjë kundërshtim për efekte të mjedisit nga zbatimi i kësaj iniciative. Puna do të rezultojë në përfitimin direkt të ambientit në afrimin e menjëhershëm të aeroportit duke përfshirë zgjerimin e tokës fermere dhe bonifikimin e rrëqeve të degraduara nga gërryerjet e dheut dhe nga ndotjet e shumta, argjila dhe dhera. Në përputhje me rekomandimet e vlerësimit , CIDA do të shikojë mundësitë e afrimit të një specialisti të agrikulturës për t'u kështilluar me planin e disponueshëm për materialet ndotëse.

Menaxhimi :Kërkesa për propozimin e një kontraktori lokal do të bëhet në Tiranë. DND do të përgatisë Termat e Referencës dhe do të jetë palë në grupin e vlerësimit me përfaqësuesin e CIDA dhe përfaqësuesin lokal . Seleksionimi i kontraktorit duhet të aprovohet nga Ministri i CIDA . Një kontratë do të nënshkruhet ndërmjet kontraktorit lokal dhe Post –it. DND do të verifikojë të gjithë faturat sipas zhvillimit të ndërtimit dhe Post do të paguajë për shpenzimet. SHQIPËRIA do të jetë përgjegjëse për çështjet e përshkruara në anekset “B” dhe “D”.

ANEKSI “B”

PLANI IMENAXHIMIT

Situata . Projekti i Aeroportit të Rinasit është iniciativë bilaterale CIDA –DND për të ndihmuar dhe rihvilluar fushën e Aviacionit të Rinasit. Aeroporti i Rinasit gjatë krizës kosovare nuk ishte vetëm Aeroporti i parë për ndihmën humanitare, por ishte gjithashtu baza kryesore për forcat e NATO –AFOR –it . Numri i madh i avionëve dhe përmasat e mëdha të tyre dëmtuan pistën , rrugët e taksingut dhe vendqëndrimin. CIDA do të mbështesë ndërtimin e vendqëndrimit të avionëve tërësisht sipas standarteve ndërkombëtare. Departamenti Kanadez i Mbrojtjes Nacionale shprehu një interes për pjesëmarrjen në këtë inisjativë dhe mori përsipër misionin e pajtimit në gusht 2000. DND ka rënë dakord të skicojë dhe mbikqyrë ekzekutimin e projektit i cili do të realizohet përmes kontraktorëve konkurrues lokalë të zgjedhur.

Misioni. Të ndërtohet 80 x 150 m shtesë vendqëndrim i ri avioni tek terminali ekzistues në Aeroportin e Rinasit.

Ekzekutimi. Paraqitje e përgjithshme : Ky projekt do të tenderohet në Shqipëri në një proces të hapur tenderimi. Financimi i projektit do të sigurohet nga CIDA dhe Departamenti Kanadez i Mbrojtjes Nacionale do të sigurojë shërbime të skicimit dhe projektin e përgjithshëm të menaxhimit Financimi Total Kanadez nuk do ti kalojë \$2,1 Cdn.

Detyrat. Projekti do të realizohet në katër faza.
 Faza I . Parapërcaktim : Kjo fazë tashmë ka filluar dhe do të përfundojë në mars 2001.
 Çështjet për t'u kryer gjatë kësaj faze janë si më poshtë :
 Agjenci : Grupi i menaxhimit të projektit i DND (P. M. team)
 Detyrat : I gjithë projekti i skicuar, duke përfshirë vizatimet dhe specifikimet e kontratës.
 Përgatitje për dokumentet e tenderit .
 Përgatitja dhe përkthimi i shpalljes së tenderit .
 Përgatitja e matricës së vlerësimit të tenderit .
 Finalizimi i marrveshjes administrative midis DND dhe CIDA.
 Plani komplet i projektit të menaxhimit si aneks i MOU ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë.
 Bërja e rregullimeve administrative për sistemin dhe transportin e grupit të punës në Shqipëri.

Agjenci CIDA

Detyrat : Ndihmë grupit PM për përgatitjen e shpalljes së tenderit .
 Ndihmë grupit PM për përgatitjen e matricës së vlerësimit të tenderit .
 Finalizimi i MOU midis Shqipërisë dhe Kanadasë
 Finalizimi i marrëveshjes administrative midis DND dhe CIDA .
 Kompletimi i impaktit të vlerësimit ambiental .

Agjenci : Qeveria e Shqipërisë (GoA)

Detyrat :Finalizimi i MOU midis Shqipërisë dhe Kanadasë .

Faza II. Paraqitja : Kjo fazë do të fillojë NLT në 4 mars 2001 dhe do të përfundojë me aprovimin e ministrit të CIDA sipas Kontratës . Detyrat që do të kryhen gjatë kësaj faze janë si më poshtë :

Agjenci :Grupi i punës i projektit të Menaxhimit i DND .
 Detyrat :Paraqitja fillestare e një personeli prej 3 vetash IDND në Shqipëri .
 Pasqyra e planit të projektit të zbatimit me Drejtorin e Aeroportit .
 Pasqyra e hapjes së tenderit me këshillimet ligjore lokale .
 Shpallja e hapjes së tenderit .
 Kontratë për përkthimin e propozimeve /ofertave .
 Organizimi i mbledhjes së tenderit dhe vendi .
 Marrja dhe vlerësimi i propozimeve /ofertave .
 Verifikimi i statusit juridik dhe financiar i kontraktorit të zgjedhur .
 Negociata e ndërtimit dhe kalendari i pagesës me kontraktorin e zgjedhur .
 Verifikimi i projektbuxhetit dhe identifikimi i ndonjë kostoje shtesë të pritshme .

Agjenci CIDA :

Detyrat: Pasqyra e hapjes së tenderit me këshillimet ligjore lokale .
 Sigurimi i vlefshmërisë së fondeve për shpalljen .
 Paraqitja e zyrarit kontraktor të CIDA në Shqipëri .
 Letra e marrë nga Qeveria e Shqipërisë për përjashtimin nga taksat e projektit.
 Marrja dhe vlerësimi i propozimeve /ofertave .
 Verifikimi i statusit juridik dhe financiar të kontraktorit të zgjedhur.
 Negociata , ndërtimi dhe kalendari i pagesave me kontraktorin e zgjedhur.
 Verifikimi i projektbuxhetit dhe identifikimi i ndonjë kosto shtesë të pritshëm.
 Riparaqitjen e zyrarit kontraktor të CIDA në Kanada.
 Marrja e aprovimit të Ministrit të CIDA sipas kontratës.

Agjenci :Qeveria Shqiptare .

Drejtori i Aeroportit të pasqyrojë planin e Projektit me grupin PM.

Faza III : Implementimi . Kjo fazë do të fillojë me aprovimin e Ministrit të CIDA sipas kontratës dhe do të përfundojë me dorëzimin e projektit autoriteve shqiptare . Detyrat që do të kryhen

gjatë kësaj faze janë si më poshtë:

Agjenci : Grupi i Menaxhimit i projektit të DND.
Detyrat : Paraqitja e pjesës së mbetur të grupit të DND në Shqipëri.
Sigurimi i koordinimit me Drejtorin e Aeroportit.
Verifikimi që kontraktori merr të gjitha lejet e ndërtimit.
Mbikqyrja e kontratës.
Ndërtimi i realizuar është ndërtuar në përputhje me projektin dhe specifikimet.
Mbikqyrja për mbrojtjen e mjedisit.
Kontrata për sigurimin cilësor të testur sipas kërkesës.
Verifikimi i të gjitha faturave dhe pagesave të rekomanduara sipas kalendarit të ndërtimit
Përgatitja e treguesve dhe raporteve financiare .
Përcaktimi komplet i ndërtimit .
Përgatitja e listës së mangësive .
Përgatitja e ndërtesës dhe dhomës së projektimit (disenjimit).
Dorëzimi i projektit në Autoritetet Shqiptare.

Agjenci : CIDA.
Detyrat : Pagesa e të gjitha faturave të rekomanduara për t'u paguar.
Kontrata me specialistin e agrikulturës për mbrojtjen e mjedisit nëse kërkohet.
Dorëzimi i projektit Autoriteteve Shqiptare.

Agjenci : Qeveria Shqiptare
Detyrat:Ndihmesa për marrjen e ndërtesave dhe lejeve të ndërtimit të kërkuara.
Drejtori i Aeroportit të koordinojë me grupin PM.

Faza IV . Riparaqitja. Kjo fazë do të fillojë me dorëzimin e projektit Autoriteteve Shqiptare dhe do të përfundojë me pagesën finale të DND nga CIDA . Detyrat për tu kryer gjatë kësaj faze janë si më poshtë :

Agjensi : Grupi i Menaxhimit të projektit të DND.
Detyra : Vendosja e të gjitha llogarive administrative në Shqipëri.
Riparaqitja e tërë grupit të projektit të Kanadasë . Paraqitja dhe bashkëngjitja në Raportin final për CIDA.
Përgatitja e faturës finale për shërbimet e DND për CIDA.
Agjenci : CIDA .
Detyrat : Pagesa e faturës finale për shërbimet e DND.
Suporti i shërbimit.
Sistemimi : Anëtarët e grupit të PM do të sistemohen në banesa me qira në Tiranë.
Transporti : Grupi i PM do të regullojë transportin dhe lëvizjet e anetarëve në Shqipëri.
Komanda dhe Sinjalet.
Menaxheri i projektit : Menaxheri i projektit për këtë projekt është Majori Andrea Penney, i forcave të Armatosura të Kanadasë.

Raportet dhe kthimet.

Raporti final :Menaxheri i projektit do të bashkëngjisë një raport final tregues (NLT) disa ditë pas dorëzimit të projektit.

Raportet e përkohshme : Menaxheri i projektit do t'i bashkëngjisë raporteve të zhvillimit të përkohshëm për CIDA IAW kalendarin e mëposhtëm:

Në zgjedhjen e kontraktorit;

kur rekomandohen pagesat.

në dorëzimin e projektit.

Kohëzgjatja : Koha për tërë aktivitetin e kalendareve është bashkëngjitur në hartën Gar.

Afatet e rëndësishme janë si më poshtë:

23 shkurt 01 Kompletimi i skicimit të projektit

09 Prill 01 Aprovimi i Ministrit të CIDA sipas kontratës

31 Korrik 01 Dorëzimi i projektit të kompletuar.

Aneksi “C”

PËRGJEGJËSITË E KANADASË

KANADAJA do të financojë shpenzimet e mëposhtme bazuar në vlerësimet e autorizuara .

1. Shpenzimet në lidhje me Personelin Kanadez:

a) Rrogat e tyre, shpërblimet, lejet dhe përfitime të tjera .

b) Shpenzimet e udhëtimit dhe të familjarëve të varur nga to , që nga vendi i tyre i qëndrimit në portën e hyrje – dalje, në Shqipëri.

c) Koston e transportit , nga vendi i tyre në portën e hyrje –dalje në Shqipëri , për pajisje personale dhe materialet profesionale dhe teknike të kërkuara nga Personeli Kanadez për kryerjen e detyrës së tyre.

Kontratat për blerjen e mallrave apo për autorizimin e shërbimeve të financuara nga KANADAJA dhe të kërkuara për kryerjen e projektit, do të nënshkruhen nga KANADAJA ose nga njëra prej agjencive të saj.

KANADAJA do të pajisë SHQIPËRINË me kohë me emrat e personelit Kanadez sipas të drejtave dhe privilegjeve të vendosura në Memorandumin e Mirëkuptimit.

Aneksi “D”

PËRGJEGJËSITË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SHQIPËRIA do të sigurojë ose paguajë për :

1. Identifikimin dhe shpërblimin në ekuivalencë të përshtatshme që të sigurojë zbatimin e projektit.

2. Çdo ndihmë zyrtare që mund të kërkohej për qëllim të lehtësimit të udhëtimit të CF dhe DND dhe personelit kanadez në kryerjen e detyrës së tyre në Shqipëri.

3. Çdo ndihmë zyrtare që mund të kërkohej për qëllim të lehtësimit të pagesave përmes doganave për pajisjet, produktet, materialet, pajisjet e zyrave dhe mallrat e tjera që nevojiten për kryerjen e projektit dhe pajisjet personale shtëpiake të personelit Kanadez.

4. Të gjitha lejet, licencat dhe dokumentet e tjera, duke përfshirë koston e tyre për CF dhe DND, për firmat dhe personelin Kanadez për të kryer funksionet e tyre në SHQIPËRI.

5. Të gjitha vizat e nevojshme dhe të gjitha lejet e import-eksportit, sipas rastit, për personelin kanadez, për pajisjet, materialet, pajisjet apo mallrat e nevojshme për kryerjen e projektit, pajisjet profesionale dhe teknike dhe pajisjet personale të personelit Kanadez .

6. Ndhimesë për të siguruar transport të menjëhershëm në vend të të gjitha mjeteve, produkteve materialeve, pajisjeve dhe të mirat e tjera të importuara të nevojshme për kryerjen e projektit, nga porta e hyrjes në Shqipëri në teritorin e projektit, duke përfshirë ku është e nevojshme, marrjen e prioritetit nga Shqipëria dhe agjentëve të transportit.

7. Lejen nga Ministria përkatëse në përputhje me ligjin përkatës dhe rregullat , për të përdorur të gjitha mjetet e komunikimit si radio transmetueset e frekuencave të larta dhe marrësit e aprovuar për përdorim në Shqipëri , telefon dhe rrjetin telegrafik , sipas nevojave të projektit .

8. Raportet, të dhënat , hartat , statistikat dhe informacione të tjera të lidhura me projektin dhe

të përshtatshme të ndihmojnë CF dhe DND dhe personelin Kanadez në kryerjen e detyrave të tyre, të siguruar që nuk janë klasifikuar dhe s'kanë asnjë lidhje me sigurinë nacionale .

9. Çdo asistencë siç përshkruhet në planin e menaxhimit.

L I G J

Nr.8800, datë 17.5.2001

PËR RATIFIKIMIN E “AMENDAMENTIT TË MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE TË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN E FURNIZIMIT TË FSHATRAVE ME UJË TË PIJSHËM”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Amendamenti i Marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Islamike të Zhvillimit për Projektin e Furnizimit të fshatrave me ujë të pijshëm”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3042, datë 5.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

PROJEKTI I UJËSJELLSAVE TË FSHATRAVEAMENDAMENT PËR MARRËVESHJEN E HUASË

Datë 7.10.1996

**NDËRMJET QEVERISË SË Republikës SHQIPËRISË
DHE BANKËS ISLAMIKE TË ZHVILLIMIT**

Ky amendament i Marrëveshjes së Huasë, datë 7.10.1996, është bërë
NDËRMJET:REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (këtu është quajtur Huamarrësi)
DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (këtu është quajtur Banka)

tani, palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Objekti i këtij Amendamenti është të plotësojë Marrëveshjen origjinale, datë 7.10.1996, si më poshtë:

Neni 1

Seksioni – 4.03, faqe 6 e Marrëveshjes origjinale, datë 7/10/1996 do të ndryshojë:

"Data e mbylljes 1.1.2004, ose një datë tjetër që do të bien dakord Huamarrësi dhe Banka është data e mbylljes së tërheqjes së vleftave monetare nga Huaja për të plotësuar kërkesat e Seksionit 6.03 (c) të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 2

Tabela –I (A), PAGESAT PJESORE, faqet 14-15 të Marrëveshjes fillestare, datë 7.10.1996 tani do të lexohet si më poshtë;

TABELA – I (A)
PAGESAT PJESORE

Vendi: Shqipëria
Projekt: Rehabilitimi i Ujësellsave të Fshatrave
Shuma e Huasë: ID 4,800,000/-
Periudha e Huasë: 25 vjet
Periudha e Lirë: 5 vjet

Numri	Datë	Pagesa Pjesore (ID)
1	1/7/2005	120,000
3	1/7/2005	120,000
3	1/1/2006	120,000
4	1/7/2006	120,000
5	1/1/2007	120,000
6	1/7/2007	120,000
7	1/1/2008	120,000
8	1/7/2008	120,000
9	1/1/2009	120,000
10	1/7/2009	120,000
11	1/1/2010	120,000
12	1/1/2011	120,000
13	1/7/2011	120,000
14	1/1/2012	120,000
15	1/7/2012	120,000
16	1/7/2012	120,000
17	1/1/2013	120,000
18	1/7/2013	120,000
19	1/1/2014	120,000
20	1/7/2014	120,000
21	1/7/2015	120,000
22	1/7/2015	120,000
23	1/1/2016	120,000
24	1/7/2016	120,000
25	1/1/2017	120,000
26	1/1/2017	120,000
27	1/1/2018	120,000
28	1/7/2018	120,000
29	1/1/2019	120,000
30	1/7/2019	120,000
31	1/1/2020	120,000
32	1/7/2020	120,000
33	1/1/2021	120,000
34	1/7/2021	120,000
35	1/1/2022	120,000
36	1/7/2022	120,000
37	1/1/2023	120,000
38	1/7/2023	120,000
39	1/1/2024	120,000
40	1/7/2024	120,000

TOTALI4,800,000

Neni 3

Tabela – I (B), PAGESA E SHËRBIMIT, faqe 16 e Marrëveshjes fillestare, datë 7/10/1996, lexohet si më poshtë:

TABELA –I (B)
PAGESA E SHËRBIMIT

Vendi: SHQIPËRI
Projekt: Rehabilitimi i Ujësellsave të Fshatrave
Shuma e Huasë: ID 4,800,000/-
Periudha e Huasë: 25 vjet
Periudha e Lirë: 5 vjet
Pagesat e Shërbimit: ID. 385,632/-

Numri	Datë	Pagesa Pjesore (ID)
1	1/1/1998	15,422
3	1/7/1998	30,850
3	1/1/1999	30,850
4	1/7/1999	30,850
5	1/1/2000	30,850
6	1/7/2000	30,850
7	1/7/2002	21,596
8	1/1/2003	21,596
9	1/7/2003	21,596
10	1/1/2004	21,596
11	1/7/2004	21,596
12	1/1/2005	21,596
13	1/7/2005	21,596
14	1/1/2006	21,596
15	1/7/2006	21,596
16	1/1/2007	21,596

TOTALI 385,632

Neni 4

Seksioni – II, PËRSHKRIMI I PROJEKTIT, faqe 17 e Marrëveshjes fillestare, datë 7/10/1996, tani lexohet si më poshtë:

SEKSIONI – II
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Financimi nga Banka Islamike do të sigurojë ujë të pijshëm nga burimet natyrale për 29 fshatra dhe 3 qytete, të cilat ndodhen në zonat malore të vendit:

i-Rrethi Malsi e Madhe (Zona e Bajzës)

ii- Rrethi Mat (Zona Klos)

iii-Rrethi Mirditë (Zona Rrëshen)

Çdo skemë ujësjellësi konsiston në veprën e marrjes me filtrimet e nevojshme duke siguruar edhe klorinimin e ujit, në ndërtimin e rezervuarëve të ujit me beton-arme. Uji i pijshëm do të furnizojë me linjat kryesore popullsinë dhe institucionet për çdo fshat. Në perspektivë parashikohet që të bëhen lidhjet nga linjat kryesore për shtëpitë dhe konsumatorët e veçantë.

Projekti do të eliminojë vështirësitë e furnizimit me ujë të pijshëm të popullsisë së 29 fshatrave dhe të 3 qyteteve, të cilat ndodhen në zonën malore të vendit. Projekti do të eliminojë gjendjen e rëndë ekzistuese të furnizimit me ujë të pijshëm nga ujrata e patrajtuara të liqeneve dhe lumenjve dhe do të ndihmojë për rritjen e treguesve ekonomikë të zonave rurale të vendit.

Ndërtimi i veprave do të zgjasë 18 muaj, ndërsa periudha e mbikqyrjes së funksionimit të tyre pas ndërtimit do të jetë 12 muaj.

Komponentët e Projektit si dhe niveli i financimit nga Banka Islamike dhe Qeveria Shqiptare janë si më poshtë:

Në 000/USD

PËRSHKRIMI	VLERA DITORE	IDB	QEVERIA E SHQIPËRISË	% IDB	%ALB
Ndërtim – montimi	5.900	5.074	826	86	14
TVSH (Tax)	1.180	—	1.180	—	100
Mbështetje Projekti	35	35	—	100	—
Shërbime konsulence dhe tenderi	299	299	—	100	—
Supervisioni, periudha e mbikëqyrjes së veprave	695	695	—	100	—
Kosto e PIU-t	135	135	—	100	—
TOTALI	8,244	6,238	2.006	76	24

PËR HUAMARRËSIN PËR BANKËN ISLAMIKE TË ZHVILLIMIT

Emri..... Emri.....
Adresa..... Adresa.....
(Datë.../.../2001) (Datë.../.../2001)

L I G J

Nr.8801, datë 17.5.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME “ELBER” SHPK DHE KFW PËR PROJEKTIN DHE HUANË PËR NDËRMARRJEN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË ELBASAN”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë me “ELBER” sh.p.k. dhe KfW për projektin dhe huanë prej 23 500 000 (njëzet e tre milionë e pesëqind mijë) DM, për ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve në Elbasan”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3043, datë 5.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE

E PROJEKTIT DHE E HUASË

Ndërmjet
KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU, Frankfurt am Main (“KfW”) dhe
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË përfaqësuar nga MINISTRIA E FINANCAVE TIRANË
 (“Huamarrësi”) dhe ELBER sh.p.k. (“Kompania Ekzekutimit të Projektit”)
për DM 23, 500, 000
Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Investimeve në Infrastrukturën komunale,
Kanalizimi dhe furnizimi me ujë, Elbasan
Në bazë të një marrëveshjeje që ende është për t’u përfunduar ndërmjet Qeverisë së
Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin
financiar dhe në bazë të një marrëveshjeje koncensionit të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Kompanisë
së Ekzekutimit të Projektit më 20 tetor 2000 (“Marrëveshje Koncensionit”), Huamarrësi, Kompania e
Ekzekutimit të Projektit dhe KfW përfshihen në Marrëveshjen e Projektit dhe të Huasë si në vijim :

Neni 1

Shuma dhe Qëllimi i Huasë

1.1 KfW do t’i japë Huamarrësit një (“Hua”) që nuk kalon
DM 23, 500, 000

1.2 Huamarrësi do ta transferojë huanë të plotë Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit në
përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 2 . Kompania e Ekzekutimit të Projektit do të përdorë
Huanë ekskluzivisht për “Promovimin e Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet investimeve në
Infrastrukturën e komunës Elbasan –Kanalizimi dhe Furnizimi me ujë – Elbasan” (“Projekti”) dhe
fillimisht për të paguar shpenzimet e Projektit të shprehura në çdo monedhë tjetër përveç Lekut
Shqiptar. Kompania e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW do të përcaktojë hollësitë e Projektit dhe të
mallrave dhe të shërbimeve që financohen nga Huaja me anë të një marrëveshjeje të veçantë.
 (“Marrëveshje e Veçantë”).

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin nga Huamarrësi ose Kompania Ekzekutuese
e Projektit dhe taksat e importit nuk financohen nga Huaja.

Neni 2

Shpërndarja e Huasë Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit

2.1 Huamarrësi do t’i transferojë Huanë Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit mbi bazën e
një marrëveshjeje huaje të veçantë (“Marrëveshje e Transferimit”), në përputhje me termat dhe kushtet
e parashikuara në nenet 4.1 deri më 4.7. Në lidhje me disbursimin e Huasë Kompanisë së Ekzekutimit
të Projektit, Huamarrësi nuk do të ngarkojë si tatim ndonjë shpenzim tjetër dhe / ose shpenzime shtesë,
taksa ose interes të çdo lloji, as direkt as indirekt, përveç atyre që janë të paracaktuara në Marrëveshje
në lidhje me Kompaninë e Ekzekutimit të Projektit .

2.2 Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi do t’i dërgojë KfW-së një kopje të
Marrëveshjes së Transferimit, siç specifikohet në nenin 2.1.

2.3 Shpërndarja e Huasë, Marrëveshja e Transferimit dhe fakti që Kompania e Ekzekutimit të
Projektit duke qenë pjesë e Marrëveshjes së Projektit dhe Huasë nuk do të përbëjnë dhe / ose krijojnë
përgjegjësi nga ana e Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit për pagesën e detyrimeve kundrejt KfW-
së në lidhje me Huanë ose transferimin e Huasë.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW do të transferojë Huanë në përputhje me ecurinë e Projektit dhe mbi kërkesën e
Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit. Në Marrëveshjen e Veçantë, Kompania e Ekzekutimit të
Projektit dhe KfW do të bien dakord për procedurën e disbursimit, në veçanti për mënyrën e paraqitjes
që vërteton se shumatat e huasë të kërkuara përdoren për qëllime të përcaktuara.

3.2 KfW ka të drejtën të refuzojë për të kryer disbursime nga Huaja pas 31 dhjetorit 2009 .

Neni 4

Shlyerja, Interesi dhe Detyrimet e angazhimit

4.1 Huamarrësi do të paguajë një detyrim angazhimi prej 0.25 % në vit për shumat e huasë të padisbursuara. Detyrimi i angazhimit lind nga dita në ditë, që nga data që është 3 muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes nga KfW dhe Huamarrësi deri në datën kur disbursimet debitohej.

4.2 Huamarrësi do të paguajë interesin prej 0.75 % në vit. Interesi llogaritet nga data e debitimit të disbursimeve deri në datat kur shlyerjet kreditohen në llogarinë e KfW-së të specializuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do të paguajë detyrimin e angazhimit, interesin dhe çdo interes për shumat e papaguara sipas nenit 4.5 dy herë në vit më 30 qershor dhe dhjetor për gjysmën e vitit që mbaron. Detyrimi i parë i angazhimit do të bëhet së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi do të shlyejë huanë si më poshtë :

Transhi	Data			Shuma
1	30 Qershor	2011	DM	391.000.00
2	30 Dhjetor	2011	DM	391.000.00
3	30 Qershor	2012	DM	391.000.00
4	30 Dhjetor	2012	DM	391.000.00
5	30 Qershor	2013	DM	391.000.00
6	30 Dhjetor	2013	DM	391.000.00
7	30 Qershor	2014	DM	391.000.00
8	30 Dhjetor	2014	DM	391.000.00
9	30 Qershor	2015	DM	391.000.00
11	30 Qershor	2016	DM	391.000.00
10	30 Dhjetor	2015	DM	391.000.00
12	30 Qershor	2016	DM	391.000.00
13	30 Dhjetor	2017	DM	391.000.00
14	30 Qershor	2017	DM	391.000.00
15	30 Dhjetor	2018	DM	391.000.00
16	30 Qershor	2018	DM	391.000.00
17	30 Dhjetor	2019	DM	391.000.00
18	30 Qershor	2019	DM	391.000.00
19	30 Dhjetor	2020	DM	391.000.00
20	30 Qershor	2020	DM	391.000.00
21	30 Dhjetor	2021	DM	392.000.00
22	30 Qershor	2021	DM	392.000.00
23	30 Dhjetor	2022	DM	392.000.00
24	30 Qershor	2022	DM	392.000.00
25	30 Dhjetor	2023	DM	392.000.00
26	30 Qershor	2023	DM	392.000.00
27	30 Dhjetor	2024	DM	392.000.00
28	30 Qershor	2024	DM	392.000.00
29	30 Dhjetor	2025	DM	392.000.00
30	30 Qershor	2025	DM	392.000.00
31	30 Dhjetor	2026	DM	392.000.00
32	30 Qershor	2026	DM	392.000.00
33	30 Dhjetor	2027	DM	392.000.00
34	30 Dhjetor	2027	DM	392.000.00
35	30 Qershor	2028	DM	392.000.00
36	30 Dhjetor	2028	DM	392.000.00
37	30 Qershor	2029	DM	392.000.00
38	30 Dhjetor	2029	DM	392.000.00
39	30 Qershor	2030	DM	392.000.00
40	30 Dhjetor	2030	DM	392.000.00
41	30 Qershor	2031	DM	392.000.00
42	30 Dhjetor	2031	DM	392.000.00
43	30 Qershor	2032	DM	392.000.00

44	30 Dhjetor	2032	DM	392.000.00
45	30 Qershor	2033	DM	392.000.00
46	30 Dhjetor	2033	DM	392.000.00
47	30Qershor	2034	DM	392.000.00
48	30Dhjetor	2034	DM	392.000.00
49	30 Qershor	2035	DM	392.000.00
50	30 Dhjetor	2035	DM	392.000.00
51	30 Qershor	2036	DM	392.000.00
52	30Dhjetor	2036	DM	392.000.00
53	30Qershor	2037	DM	392.000.00
54	30 Dhjetor	2037	DM	392.000.00
55	30 Qershor	2038	DM	392.000.00
56	30 Dhjetor	2038	DM	392.000.00
57	30 Qershor	2039	DM	392.000.00
58	30 Dhjetor	2039	DM	392.000.00
59	30 Qershor	2040	DM	392.000.00
60	30 Dhjetor	2040	DM	392.000.00
Totali				23,500.000.00

4.5 Nëse transha e shlyerjes kundrejt KfW nuk bëhet në zonën e duhur, KfW mund të rrisë përqindjen e interesit për shumat e pashlyera me 3 % në vit mbi interesin bazë për periudhën që fillon nga data e duhur dhe duke mbaruar në datën kur këto shlyerje kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 4.9. “Interesi bazë” është interesi i shpallur nga Banka Qendrore Europiane si interesi bazë që zbatohet në ditën përkatëse të duhur. Në rastin e interesit të shumave të pashlyera, KfW mund të pretendojë dëme nga Huamarrësi. Dëme të tilla nuk duhet të kalojnë shumën që do të arrihej nëse Interesi do të ngarkohej mbi interesat e shumave të pashlyera me një përqindje bazë mbizotërruese në datën e duhur plus interesin prej 3 % në vit.

4.6 Detyrimi i angazhimit, interesi dhe çdo detyrim i shumave të pashlyera sipas nenit 4.5 do të llogaritet në bazë të vitit kalendarik prej 360 ditësh dhe muajit prej 30 ditësh.

4.7 Shumat e huasë të padisbursuara ose të shlyera para kohe do të kreditohen në proporcione të barabarta kundrejt të gjitha transheve të pashlyera nëse vetë KfW-ja nuk përcakton një mënyrë tjetër në një rast të veçantë, veçanërisht në rastin e shumave me një volum më të ulët.

4.8 KfW është titullarja për të kredituar sipas gjykimit të tij, pagesat e marra kundrejt pagesave të përcaktuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose të marrëveshjeve të tjera huaje të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi do të kryejë pagesat në monedhën e Republikës Federale të Gjermanisë në llogarinë e KfW-së me nr. 22.3954.7450 pranë Kreditanstalt für Wfederalaufbau, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, S .W.I.F.T. KFWIDEFF), pa ndalime të kundërpretendimeve kundër këtyre pagesave .

Neni 5

Shlyerja e parakohshme dhe pezullimi i disbursimeve

5.1 Huamarrësi mund në çdo kohë:

a) Duke iu referuar përmbushjes së detyrimeve, sipas nenit 8 dhe në bazë të dhënies paraprake të pëlqimit të shkruar nga KfW, të anullojë çdo shumë huaje ende të padisbursuar, dhe

b) të shlyejë huanë të plotë ose një pjesë përpara maturimit.

5.2 KfW mund të pezullojë disbursimet vetëm nëse :

a) Huamarrësi nuk ka kryer detyrimet kundrejt KfW për të kryer pagesa në kohën e duhur;

b) detyrimet e kësaj Marrëveshjeje ose të marrëveshjeve të veçanta që lidhen me këtë Marrëveshje janë shkelur;

c) Kompania e Ekzekutimit të Projektit pas kërkesës së KfW, nuk është në gjendje të vërtetojë se shumat e huasë janë përdorur për qëllimet e përcaktuara; ose

d) shfaqen rrethana të jashtëzakonshme që vënë në rrezik zbatimin, veprimin ose qëllimin e Projektit ose kryerjen e detyrimeve të pagesave që Huamarrësi merr përsipër sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.3 Nëse është shfaqur ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 5.2 a), b), ose c), dhe nuk

është eliminuar brenda afatit të përcaktuar nga KfW, që duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW mund:

a) të kërkojë në rastet e specifikuara në nenin 5.2 a) ose 5.2 b), shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të huasë të pashlyera, si dhe pagesën e të gjitha interesave rrjedhëse dhe detyrimeve të tjera të rastit;

b) të kërkojë në rastin e specifikuar në nenin 5.2 c), shlyerjen e menjëhershme të shumave të huasë ndërsa Kompania e Ekzekutimit të Projektit nuk është në gjendje të vërtetojë që shumat janë përdorur sipas qëllimit të përcaktuar.

Neni 6

Kostot dhe Shpenzimet Publike

6.1 Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje, pa ndonjë zbritje për taksat, shpenzimet e tjera publike ose kosto të tjera, dhe do të paguajë kostot që lindin gjatë transfertës dhe konvertimit në lidhje me disbursimin e Huasë.

6.2 Huamarrësi do të mbarti të gjitha taksat dhe shpenzime të tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Vlefshmëria dhe Përfaqësimi i Marrëveshjes

7.1 Në kohën e duhur para disbursimit të parë, Huamarrësi do të pajisë KfW me evidenca të kënaqshme që vërtetojnë se Huamarrësi ka përmbushur sipas ligjeve kushtetuese dhe ligjeve të tjera, të gjitha kërkesat në lidhje me marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve të saj të kësaj Marrëveshjeje. Kompania e Ekzekutimit të Projektit garanton, duke iu bashkuar kësaj Marrëveshjeje, se është formuar siç duhet mbi bazën e ligjit shqiptar për qëllimin që pasqyrohet në Marrëveshjen e Koncensionit.

7.2 Ministri i Financave dhe personat e emëruar nga ai ose ajo për KfW dhe personat për firmat e autorizuar nga ai ose ajo do të përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm i Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit dhe personat e emëruar të KfW –së nga ai ose ajo dhe personat për firmat e autorizuar të vërtetuara nga ai ose ajo do të përfaqësojnë Kompaninë e Ekzekutimit të Projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk është më e vlefshme kur ata japin dorëheqjen me anë të përfaqësuesve të autorizuar në kohën kur e merr njoftimin KfW .

7.3 Amendamentet e Marrëveshjes dhe çdo njoftim dhe pohime të lëshuara nga palët kontraktuese sipas Marrëveshjes do të jetë në formë të shkruar.

Çdo njoftim ose pohim quhet i marrë kur mbërrin në adresën e palës kontraktuese korrespondente ose në adresë tjetër nga kjo, ashtu siç është njoftuar palës tjetër kontraktuese.

Për KfW :Kreditanstalt fur Wiederaufbau

Pastfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republik of Germany

Telefax : + + 49 /69 /74 31 –29 44

Telex : 41525 60 kwd

Për Huamarrësin :

Ministria e Financave

Bulevardi : Dëshmorët e Kombit

Tirana, Republika e Shqipërisë

Telefax :++355/42 /28 494

Për Kompaninë e Ekzekutimit të Projektit

Elber Sh.p.k Elbasan

Elbasan

Republika e Shqipërisë

7.4 Amendamentet e Marrëveshjes që ushtrojnë ndikim vetëm mbi marrëdhënien ligjore midis KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë aprovimin e Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit.

Neni 8 Projekti

8.1 Kompania e Ekzekutimit të Projektit:

a) do të përgatisë, zbatojë, veprojë dhe do të mirëmbajë Projektin në përputhje me treguesin financiar dhe praktikën inxhinierike dhe në përputhje me konceptimin e Projektit të rënë dakord midis Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit dhe KfW-së;

b) do të caktojë konsulantë gjermanë të kualifikuar dhe të pavarur për përgatitjen dhe mbikqyrjen e punimeve të Projektit si dhe firma të kualifikuara për zbatimin e Projektit për atë kohë sa nuk përmbushet kryerja e shërbimeve për të cilat është rënë dakord më parë nga KfW –nga departamenti i investimeve të Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit;

c) në lindje me përmbajtjen e pikës b) sa më sipër, kontratat për mallrat dhe shërbimet financohen nga Huaja më parë mbi bazën e ofertave kompetitive; përjashtimet nga kjo pasqyrohen në Marrëveshjen e Veçantë;

d) do të mirëmbajë ose të përpiqet të mirëmbajë, librat dhe regjistrat që pasqyrojnë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të Projektit dhe do të identifikojë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

e) do të mundësojë përfaqësuesit e KfW-së që, në çdo kohë, të kontrollojnë këto libra dhe regjistra, si dhe të gjithë dokumentacionin që ka lidhje me zbatimin e Projektit, si dhe të gjitha instalimet përkatëse; dhe

f) do t'i sigurojë KfW-së dhe Ministrisë së Financave informacion dhe raporte mbi Projektin, në lidhje me ecurinë e tij, sipas kërkesës së KfW-së dhe Ministrisë së Financave;

8.2 Huamarrësi dhe Kompania e Ekzekutimit të Projektit:

a) do të marrin përsipër financimin e plotë të Projektit dhe mbi bazë të kërkesës do t'i sigurojë KfW evidencë që vërteton se kostot e paguara nga kjo Hua janë të mbuluara nga burime të tjera me anë të një kontributi të barabartë të paktën prej 5 milion DM nga BWI dhe një huaje dytësore, të paktën në shumën prej 5 milion DM nga BWI për kompaninë e Koncensionit të Ujit Elbasan dhe

b) do të njoftojë menjëherë KfW-së sipas pëlqimit të tyre për çdo rrethanë që ndalon ose vë në rrezik, veprimin ose qëllimin e Projektit .

8.3 Kompania e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW do të parashtrojnë detajet që lidhen me nenet 8.1 dhe 8.2 në Marrëveshjen e Veçantë.

8.4 Huamarrësi do të ndihmojë Kompaninë e Ekzekutimit të Projektit, në përputhje me treguesit inxhinierikë dhe praktikën financiare për zbatimin e Projektit dhe në kryerjen e detyrimeve të Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, të japë ose të bëjë që çdo njësi shtetërore, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Koncensionit, t'i japë të gjitha lejet e nevojshme Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit për zbatimin e Projektit.

8.5 Për transportin e mallrave që financohen nga huaja do të aplikohen kushtet e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat njihen nga Huamarrësi .

Neni 9 Kushte të ndryshme

9.1 Nëse ndonjë nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk është e vlefshme, të gjitha kushtet e tjera nuk do të ndikohen. Çdo diferencë që rezulton do të mbulohet nga një kusht i qëndrueshëm me qëllimin e Marrëveshjes.

9.2 Huamarrësi dhe Kompania e Ekzekutimit të Projektit nuk mund të caktojnë ose të transferojnë, vënë peng ose hipotekojnë pretendimet që lindin nga kjo Marrëveshje.

9.3 Marrëveshja rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi do të jetë Frankfurt am Main. Në rast dyshimi për interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti gjerman do të ketë prioritet.

9.4 Të gjitha debatet që lindin si dhe të gjitha debatet në lidhje me vlefshmërinë e Marrëveshjes dhe Marrëveshjen Arbitrare që nuk mund të zgjidhen në mënyrë miqësore midis Palëve kontraktuese do t'i drejtohen procedurave gjyqësore në përputhje me Marrëveshjen Arbitrare duke përbërë një pjesë përfshirëse të Marrëveshjes .

9.5 Huaja dhe Marrëveshja e Projektit nuk hyjnë në fuqi deri sa Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën bazohet, të ketë hyrë në fuqi.

9.6 Të gjitha shumat e cituara në këtë dokument në DM do të konvertohen në Euro me kursin 1 Euro = dm 1. 95583 më 1 janar 2002.

9.7 Nëse Kompania e Ekzekutimit të Projektit nuk është formuar në kohën kur kjo Marrëveshje është lidhur nga KfW dhe Huamarrësi, Kompania e Ekzekutimit të Projektit do të pranohet dhe do të bëhet pjesë e Marrëveshjes brenda 3 muajve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes nga KfW dhe Huamarrësi me anë të nënshkrimit të një kopjeje origjinale të Marrëveshjes. Nëse Kompania e Ekzekutimit të Projektit nuk përfshihet në këtë Marrëveshje brenda 3 muajve të përmendur, KfW dhe Huamarrësi do të përcaktojnë së bashku nëse Marrëveshja vazhdon të jetë e vlefshme.

Bërë në 6 kopje origjinale, 3 në gjermanisht dhe 3 në anglisht.

Frankfurt, kjo _____ Tiranë, kjo _____

KREDITANSTALT REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FUR WIEDERAUFBAU Përfaqësuar nga

MINISTRIA E FINANCAVE

ELBER Sh.p.k , ELBASAN

L I G J

Nr.8802, datë 17.5.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NO.ABA-R1-2-D PËR SHTYRJEN E BORXHEVE QË RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E HUASË NO.ABA-P1 E DATËS 28 NËNTOR 1995 NDËRMJET KOORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja No.ABA-R1-2-D për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga marrëveshja e huasë No.ABA-P1 e datës 28 nëntor 1995 ndërmjet Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3044, datë 5.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Marrëveshje

no. ABA-R1-2-D, datë 22 mars 2001 për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga Marrëveshja e Huasë No.ABA-P1, datë 28 Nëntor 1995, ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunimin NDërkombëtar dhe Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare

Në vazhden e shkëmbimit të Notave ndërmjet Qeverisë së Japonisë dhe Qeverisë së

Republikës së Shqipërisë datë 23 nëntor 2000, lidhur me masat për lehtësimin e borxhit, Banka Japoneze për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (më pas e quajtur “Banka”) dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (më poshtë e quajtur “Huamarrësi”), bien dakord (më poshtë e quajtur “Marrëveshje Shtyrjeje”) të kryejnë ndryshimet e mëposhtëme lidhur me termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me pagesën e interesit për huanë No. ABA-P1 të datës 28 nëntor 1995 (më poshtë e quajtur “Marrëveshja Originale”) ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

Neni 1

1. Huamarrësi do t’i paguajë Bankës pesë milion e tetëdhjetë e tetë mijë e një Jen Japonez (5,088,001 Jen) që përfaqëson shumën e përgjithshme të (a) interesit, sipas marrëveshjes origjinale, që duhet paguar përpara 30 qershorit 2000 dhe që nuk është paguar dhe (b) interesi mbi shumën e interesit të përcaktuar në pikën (a) më lart, i llogaritur për periudhën ndërmjet 20 korrikut 1999 dhe 30 qershorit 2000, të dyja datat të përfshira; përqindja e këtij interesi është 1.7% në vit. Kjo shumë më poshtë do të quhet “Shuma e Shtyrë” dhe është paraqitur në Aneksin 1.

2. Huamarrësi do të paguajë Shumën e Shtyrë në dhjetë (10) këste të barabarta e të njëpasnjëshme gjashtëmujore, duke filluar nga 30 qershori 2001. Kalendari i pagesës është paraqitur në Aneksin 2 bashkëlidhur.

3. Huamarrësi do të paguajë një interes prej 1.7% në vit mbi shumën e mbetur të Shumës së Shtyrë. Llogaritja e këtij interesi do të fillojë nga 1 korriku 2000.

4. Huamarrësi do t’i paguajë Bankës më 30 qershor të çdo viti interesin e grumbulluar që nga 31 dhjetori i vitit parardhës deri në 29 qershor të atij viti; dhe në 31 dhjetor të çdo viti interesin e grumbulluar që nga 30 qershori i atij viti deri në 30 dhjetor.

5. Banka, menjëherë pas bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje Shtyrjeje do të njoftojë Huamarrësin mbi shumën e interesit që duhet paguar.

Neni 2

Në qoftë se, pagesat e principalit ose të interesit të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me vonesë, interesi për të cilin flitet në paragrafin 3 të nenit 1 nuk do të zbatohet për këto shuma të vonuara. Në vend të tij do të përdoret një përqindje prej 3.7% në vit për periudhën që nga data kur duhet kryer pagesa deri në ditë përpara datës faktike të bërjes së pagesës (të dyja datat të përfshira).

Neni 3

Kjo Marrëveshje Shtyrjeje është pjesë përbërëse e Marrëveshjes Originale dhe të gjitha kushtet dhe termat e kësaj të fundit që nuk preken nga kjo Marrëveshje Shtyrjeje do të mbeten në fuqi të plotë.

Neni 4

1. Kjo Marrëveshje do të shoqërohet nga një Garanci për Shtyrjen e Borxheve në formën e paraqitur në Aneksin 3, e cila do të ekzekutohet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe që do t’i jepet Bankës menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje për shtyrjen e Borxheve.

2. Kjo Marrëveshje Shtyrjeje do të bëhet efektive në datën në të cilën Banka deklaron se garancia për Shtyrjen e Borxheve, e përmendur në paragrafin më lart, është e pranueshme për të.

Në dëshmi të kësaj, Banka dhe Huamarrësi, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, bënë që kjo Marrëveshje të kryhet siç duhet, në emrat e tyre respektive, në ditën dhe vitin e përcaktuar më lart.

Për Bankën Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Hiroshi Yasuda
Guvernator

Për Korporatën Elektroenergjetike
Shqiptare

Dritan Prifti
Drejtor i Përgjithshëm

Datë: 22 mars 2001
Vendi: Chiyoda-ku, Tokio
Japoni

Datë: 16 shkurt 2001
Vendi: Tiranë
Shqipëri

ANEKSI 1
Përbërja e Shumave të Shtyra

Interesi sipas Marrëveshjes Originale (në Jen Japonez)
Data origjinale e pagesës Shuma

20.7.1999	519
20.1.2000	5,049,143
Gjithsej	5,049,662

Interesi i llogaritur mbi borxhet e mësipërme

Shuma	Nr. i ditëve	Periudha	Shuma
519	184	20.7.1999-19.1.2000	4
5,049,662	163	20.1.2000-30.6.2000	38,335
Gjithsej			38,339
(a) + (b) gjithsej Shuma e Shtyrë		5,088,001	

ANEKSI 2
Kalendari i pagesës së Shumës së Shtyrë

Këstet	Data e pagesës	Shuma (në Jen Japonez)
1.	30 qershor 2001	516,001
2.	31 dhjetor 2001	508,000
3.	30 qershor 2002	508,000
4.	31 dhjetor 2002	508,000
5.	30 qershor 2003	508,000
6.	31 dhjetor 2003	508,000
7.	30 qershor 2004	508,000
8.	31 dhjetor 2004	508,000
9.	30 qershor 2005	508,000
10.	31 dhjetor 2005	508,000
Gjithsej		5,088,001

ANEKSI III
Garancia për Shtyrjen e Borxheve

Datë:
Ref.No.:
Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Tokio, Japoni
Në vëmendje të: Guvernatorit
Zotëri:
Garanci për shtyrjen e borxheve
Lidhur me huanë prej njëmiliard e gjashtëqind e tetëdhjetë e një milion Jen Japonez (Y

1,681,000,000) dhënë Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (më poshtë “Huamarrësi”) nga Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (më poshtë “Banka”) sipas Marrëveshjes së Huasë No. ABA-P1, datë 28 Nëntor 1995, ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, Marrëveshje e cila është garantuar nga Garancia për Huanë, datë 22 Nëntor 1995, nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë (më poshtë “Garantuesi”) dhe që është ndryshuar me Marrëveshjen për Shtyrjen e Borxhit No ABA-R1-2-D, datë 22 mars 2001 ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit (me poshtë e quajtur “Marrëveshje për Shtyrjen e Borxhit”), Unë, i nënshkruari, duke vepruar për dhe në emër të Garantuesit, konfirmoj:

1. Garantuesi ka pranuar përmbajtjen e Marrëveshjes për Shtyrjen e Borxhit.
2. Garantuesi bie dakord të garantojë pagesën në shumën dhe kohën e duhur të secilës ose të të gjitha shumave që duhen paguar në përputhje me nenet 1 dhe 2 të Marrëveshjes për Shtyrjen e Borxhit
3. Garantuesi konfirmon që garancia për huanë e përmendur më lart do të mbetet në fuqi të plotë, me përjashtim të atyre termave dhe kushteve të detyrimeve të Garantuesit, që do të ndryshohen nga garancia e përmendur në paragrafin 2 më lart.

Në dëshmi të kësaj, Unë, i nënshkruari, kam nënshkruar dhe vulosur sot, më datë 27 shkurt 2001.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Anastas Angjeli

Ministër i Financave

No. ABA-R1-2-D

Kalendari i pagesave të interesit për shumën e riskeduluar

Njësia: Yen Japonez

Data	Interesi	Shuma e riskeduluar e mbetur	Periudha
30 qershor 2001	86,259	5,088,001	1.7.2000-29.6.2001
31 dhjetor 2001	39,181	4,572,000	30.6.2001-30.12.2001
30 qershor 2002	34,260	4,064,000	31.12.2001-29.6.2002
31 dhjetor 2002	30,474	3,556,000	30.6.2002-30.12.2002
30 qershor 2003	25,695	3,048,000	31.12.2002-29.6.2003
31 dhjetor 2003	21,767	2,540,000	30.6.2003-30.12.2003
30 qershor 2004	17,224	2,032,000	31.12.2003-29.6.2004
31 dhjetor 2004	13,060	1,524,000	30.6.2004-30.12.2004
30 qershor 2005	8,565	1,016,000	31.12.2004-29.6.2005
31 dhjetor 2005	4,353	508,000	30.6.2005-30.12.2005
Gjithsej	280,838		

L I G J

Nr.8803, datë 17.5.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NO.ABA-R1-1-D PËR SHTYRJEN E BORXHEVE QË RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E HUASË NO.ABA-C1 E DATËS 11 MAJ 1994 NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja No.ABA-R1-1-D për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga

Marrëveshja e huasë No.ABA-C1 e datës 11 maj 1994 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3045, datë 5.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE

no. ABA-R1-1-D, datë 22 mars 2001, për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga Marrëveshja e Huasë No.ABA-C1, datë 11 maj 1994 ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunimin NDërkombëtar dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

Në vazhden e shkëmbimit të Notave ndërmjet Qeverisë së Japonisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë datë 23 nëntor 2000, lidhur me masat për lehtësimin e borxhit, Banka Japoneze për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (më pas e quajtur “Banka”) dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë (më poshtë e quajtur “Huamarrësi”), bien dakord (më poshtë e quajtur “Marrëveshje Shtyrjeje”) të kryejnë ndryshimet e mëposhtme, lidhur me termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me pagesën e interesit për huanë No. ABA-C1, të datës 11 maj 1994 (më poshtë e quajtur “Marrëveshja Origjinale”) ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

Neni 1

1.Huamarrësi do t'i paguajë Bankës njëzet e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e tetëdhjetë e katër Jen Japonez (21,854,384 Jen) që përfaqëson shumën e përgjithshme të (a) interesit, sipas marrëveshjes origjinale që duhet paguar përpara 30 qeshorit 2000 dhe që nuk është paguar dhe (b) interesi mbi shumën e interesit të përcaktuar në pikën (a) më lart, i llogaritur për periudhën ndërmjet 20 nëntorit 1999 dhe 30 qershorit 2000, të dyja datat të përfshira; përqindja e këtij interesi është 1.7% në vit. Kjo shumë më poshtë do të quhet “Shuma e Shtyrë” dhe është paraqitur në Aneksin 1.

2. Huamarrësi do të paguajë Shumën e Shtyrë në dhjetë (10) këste të barabarta e të njëpasnjëshme gjashtëmujore, duke filluar nga 30 qershori 2001. Kalendari i pagesës është paraqitur në Aneksin 2 bashkëlidhur.

3. Huamarrësi do të paguajë një interes prej 1.7% në vit mbi shumën e mbetur të Shumës së Shtyrë. Llogaritja e këtij interesi do të fillojë nga 1 korriku 2000.

4. Huamarrësi do t'i paguajë Bankës në 30 qershor të çdo viti interesin e grumbulluar që nga 31 dhjetori i vitit parardhës deri në 29 qershor të atij viti; dhe në 31 dhjetor të çdo viti interesin e grumbulluar që nga 30 qershori i atij viti deri në 30 dhjetor.

5. Banka, menjëherë pas bërjes efektive të kësaj Marrëveshje Shtyrjeje, do të njoftojë Huamarrësin mbi shumën e interesit që duhet paguar.

Neni 2

Në qoftë se pagesat e principalit ose të interesit të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me vonesë, interesi për të cilin flitet në paragrafin 3 të nenit 1 nuk do të zbatohet për këto shuma të vonuara. Në vend të tij do të përdoret një përqindje prej 3.7% në vit për periudhën që nga data kur duhej kryer pagesa deri një ditë përpara datës faktike të bërjes së pagesës (të dyja datat të përfshira).

Neni 3

Kjo Marrëveshje Shtyrjeje është pjesë përbërëse e Marrëveshjes Origjinale dhe të gjitha kushtet dhe termat e kësaj të fundit që nuk preken nga kjo Marrëveshje Shtyrjeje do të mbeten në fuqi

të plotë.

Neni 4

Kjo Marrëveshje Shtyrjeje do të bëhet efektive në ditën dhe vitin e përcaktuar më lart.

Në dëshmi të kësaj, Banka dhe Huamarrësi, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, bën që kjo Marrëveshje të kryhet siç duhet, në emrat e tyre respektivë, në ditën dhe vitin e përcaktuar më lart.

Për Bankën Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Hiroshi Yasuda
Guvernator

Datë: 22 mars 2001

Vendi: Chiyoda-ku, Tokio
Japoni

Për Qeverinë e Republikës
së Shqipërisë

Anastas Angjeli
Ministër i Financave

Datë: 29 janar 2001

Vendi: Tiranë

ANEKSI 1

Përbërja e Shumave të Shtyra

a) Interesi sipas Marrëveshjes Origjinale
(në Jen Japonez)

Data origjinale e pagesës Shuma

20.11.1999 10,919,013

20.5.2000 10,800,328

Gjithsej 21,719,341

(b) Interesi i llogaritur mbi borxhet e mësipërme

Shuma	Nr. i ditëve	Periudha	Shuma
10,919,013	182	20.11.1999-19.5.2000	92,557
21,719,341	42	20.5.2000-30.6.2000	42,486

Gjithsej 135,043

(a) + (b) gjithsej Shuma e Shtyrë 21,854,384

ANEKSI 2

Kalendari i pagesës së Shumës së Shtyrë

Këstet	Data e pagesës	Shuma (në Jen Japonez)
1.	30 qershor 2001	2,189,384
2.	31 dhjetor 2001	2,185,000
3.	30 qershor 2002	2,185,000
4.	31 dhjetor 2002	2,185,000
5.	30 qershor 2003	2,185,000
6.	31 dhjetor 2003	2,185,000
7.	30 qershor 2004	2,185,000
8.	31 dhjetor 2004	2,185,000
9.	30 qershor 2005	2,185,000
10.	31 dhjetor 2005	2,185,000
Gjithsej		21,854,384

No. ABA-RI-1-D

Kalendari i pagesave të interesit për shumën e riskeduluar

Njësia: në Yen Japonez

Data e pagesës	Interesi	Shuma e riskeduluar e mbetur	Periudha
30 qershor 2001	370,506	21,854,384	1.7.2000-29.6.2001
31 dhjetor 2001	168,526	19,665,000	30.6.2001-30.12.2001
30 qershor 2002	147,358	17,480,000	31.12.2001-29.6.2002
31 dhjetor 2002	131,076	15,295,000	30.6.2002-30.12.2002
30 qershor 2003	110,519	13,110,000	31.12.2002-29.6.2003
31 dhjetor 2003	93,625	10,925,000	30.6.2003-30.12.2003
30 qershor 2004	74,086	8,740,000	31.12.2003-29.6.2004
31 dhjetor 2004	56,175	6,555,000	30.6.2004-30.12.2004
30 qershor 2005	36,839	4,370,000	31.12.2004-29.6.2005
31 dhjetor 2005	18,725	2,185,000	30.6.2005-30.12.2005
Gjithsej	1,207,435		

L I G J

Nr.8804, datë 17.5.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË RRUGËS KOMBËTARE ELBASAN-LIBRAZHD”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për rindërtim dhe zhvillim, për projektin e rehabilitimit të Rrugës Kombëtare Elbasan-Librazhd”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3046, datë 5.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE HUAJE

(Projekti i emerGjencës së rehabilitimit të rrugëve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për rindërtim dhe zhvillim

HYRJJE

Ndërsa Banka është krijuar për të siguruar financime për projektet specifike që do të thellojnë tranzicionin drejt ekonomive me orientim tregun e hapur dhe për të nxitur iniciativën private dhe sipërmarrjet në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore me angazhimin për të dhe duke zbatuar parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

Ndërsa Huamarrësi synon të implementojë Projektin e përshkruar me skedulin 1, i cili synon të ndihmojë huamarrësin në rehabilitimin e 30.5 km seksion rrugor në Korridorin Lindje-Perëndim, ndërmjet Elbasanit dhe Librazhdit;

Ndërsa Banka është në procesin e përgatitjes së fondeve të bashkëpunimit teknik në baza granti me shumën 1.800.000 Euro për të ndihmuar Huamarrësin në implementimin e pjesës B të projektit;

Ndërsa Huamarrësi synon të sigurojë, me mbështetjen e Bankës, marrjen e fondit grant nga Iniciativa e Europës Qendrore në shumën 1.700.000 Euro dhe dhënien grant ose në formën e huasë nga Qeveria e Italisë ose një agjenci ose një nëndarje politike në shumën 2.300.000 Euro për implementimin e pjesës a-2 të projektit;

Ndërsa Banka ka rënë dakord në bazë të inter alia, sa më sipër të japë një hua Huamarrësit në shumën e 10.000.000 Euro në bazë të termave të kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje.

Kështu që Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termat standarde dhe kushtet: përkufizimet, titujt

Seksioni 1.01 Përmbajtja e Termave Standarde dhe Kushteve

Të gjitha klauzolat, termat Standarde dhe Kushtet të shkurtit 1999 janë përfshirë dhe janë bërë të aplikueshme në këtë Marrëveshje me të njëjten fuqi e efekt siç ato janë dhënë plotësisht këtu më poshtë (si klauzolat janë quajtur “termat standarde dhe kushtet”).

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë hyrjen dhe Skedulin), me përjashtim vetëm ku deklarohet ndryshe, termat e përdorur në Hyrje kanë kuptimin respektiv siç përshkruhet nëpërmjet kësaj; termat të përcaktuara në kushte dhe termat standarde kanë kuptimet përkatëse, siç përshkruhen nëpërmjet saj dhe termat që vijojnë kanë kuptim si më poshtë.

“Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit” nënkupton Ministrin e Financave të Huamarrësit.

“Fonde CEI” nënkupton fondet grant në një shumë jo më të madhe se 1,700,00 Euro të rënë dakort midis Huamarrësit dhe Iniciativës së Europës Qendrore.

“Programi ESAF” nënkupton Programin 2 të FMN-së për rregullimin strukturor të datës 13 maj 1998.

“Projekti i Korridorit Lindje-Perëndim” nënkupton programin e riparimit, rehabilitimit dhe sigurimin e përmirësimeve, përfshirë Projektin e që zbatohet në rrugën në korridorin Lindje-Perëndim, i cili është 71.5 km autostradë nga Durrësi-Varnë të Republikës së Shqipërisë.

“VF” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit i cili fillon më 1 janar të çdo viti.

“Financimi grant” nënkupton fondin e Qeverisë Italiane, fondet CEI dhe zëvendësimin me grante ose hua me kushte lehtësuese, aprovuar nga Banka.

“IDA” nënkupton Shoqatën Ndërkombëtare të Zhvillimit, anëtare e Bankës Botërore.

“Projekti i Transportit të IDA-s” nënkupton, herë pas here, ndonjë projekt financiar nga IDA për ndërtimin ose rehabilitimin e linjave të transportit, përfshirë rrugët, hekurudhat dhe portet në territorin e Huamarrësit.

“Marrëveshje kredie e IDA-s” nënkupton marrëveshjen e kredisë ndërmjet Huamarrësit dhe Agjencisë së Zhvillimit Ndërkombëtar, datë 17 korrik 1996 e siguron inter alia, për një hua prej 25.000.000 USD për financimin e projektit Korridorin Lindje – Perëndim jashtë fushës së Projektit.

“FMN” nënkupton Fondin Monetar Ndërkombëtar.

“Fonde të Qeverisë Italiane” nënkupton një grant ose një hua me kushte lehtësuese në shumë minimale të 2,300,000 Euro që ka siguruar Huamarrësi nga Qeveria Italiane ose një agjenci ose nëndarje politike.

“Të drejtat mbi tokën” nënkupton të drejtat për përdorimin e tokës së domosdoshme për implementimin e Projektit, siç përcaktohet nga konsulentët e Projektit.

“PIU” nënkupton njësinë e implementimit të Projektit e krijuar nga Huamarrësi për të menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar në të gjitha aspektet e implementimit të Projektit Korridor Lindje-Perëndim, përfshirë gjetjen e mallrave, punëve dhe shërbimeve për Projektin e Korridorit Lindje-Perëndim.

“Konsulentët e Projektit” nënkupton konsulentët e marrë në punë nga Huamarrësi, sipas Seksionit 3.05.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje një referencë për një nen, paragraf ose skedul do të komentohet duke iu referuar atij neni, paragrafi ose skeduli të specifikuar në këtë Marrëveshje, përjashtuar rastet kur parashikohet ndryshe.

Neni 2

Termat kryesore të huasë

Seksioni 2.01 Shuma e huasë dhe monedha e huasë

Banka bie dakort t’i japë Huamarrësit, në termat dhe kushtet e parashtruara ose referuar në këtë Marrëveshje, një shumë prej 10.000.000 Euro.

Seksioni 2.02 Terma të tjera financiare të Huasë.

- Minimumi shumës së tërhequr do të jetë 100.000 Euro.
- Minimumi i shumës së parapaguar do të jetë 1.000.000 Euro.
- Minimumi i shumës së anuluar do të jetë 1.000.000 Euro.
- Data e pagimit të interesit do të jetë 18 Qershor dhe 18 Dhjetor të çdo viti.
- Huamarrësi do të shlyejë principalin e Huasë në datat dhe shumat e mëposhtme:

Data e shlyerjes së huasë	Shuma e principalit
18 qershor 2003	416.666.00
18 dhjetor 2003	416.666.00
18 qershor 2004	416.666.00
18 dhjetor 2005	416.666.00
18 qershor 2005	416.666.00
18 dhjetor 2006	416.666.00
18 qershor 2007	416.666.00
18 dhjetor 2007	416.666.00
18 qershor 2008	416.666.00
18 dhjetor 2008	416.666.00
18 qershor 2009	416.666.00
18 dhjetor 2009	416.666.00
18 qershor 2010	416.666.00
18 dhjetor 2010	416.666.00
18 qershor 2011	416.666.00
18 dhjetor 2011	416.666.00
18 qershor 2012	416.666.00
18 dhjetor 2012	416.666.00
18 qershor 2013	416.666.00
18 dhjetor 2013	416.666.00
18 qershor 2014	416.666.00
18 dhjetor 2014	416.666.00
TOTAL	10.000.000.00

f) Data e fundit e vlefshmërisë do të jetë 17 qershor 2003.

g) Përqindja e Komisionit të Angazhimit do të jetë (0.5%) për vit.

h) Huaja është subjekt i një norme interesi fiks, sipas qëllimeve që jepen seksionit 3.04 b) të kushteve dhe termave standarde. Tregu i përqindjes së interesit përkatës do të jetë 6.22% në vit.

Seksioni 2.03 Tërheqjet

(a) Shumat e vlefshme mund të tërhiqen kohë pas kohe, në përputhje me klauzolat e Skedulit 2 për shpenzimet e bëra (ose n.q.s Banka bie dakort për t’u bërë), duke respektuar (I) përputhjen e

kostos së mallrave, punëve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe për t'u financuar jashtë të ardhurave të huasë dhe (ii) komisionit front-end.

(b) Huamarrësi autorizon Bankën të tërheqë nga Shuma e vlefshme një shumë të barabartë me komisionin front-end dhe t'i paguajë vetes këtë komision në emër të Huamarrësit.

Neni 3 **Ekzekutimi i projektit**

Seksioni 3.01 Premtime të tjera afirmative të Projektit

Në vazhdim të ndërmarrjeve të parashtruara në nenin 4 dhe 5 të Termave Standarde dhe Kushteve, Huamarrësi duhet, përveç kur Banka bie dakort ndryshe:

(a) të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar fondet adekuate për përfundimin e Projektit dhe të bëjë të gjitha fondet e tilla të vlefshme për projektin si kontribute të parimbursueshme për të financuar koston e projektit, dhe

(b) të përmbushë të gjitha detyrimet e saj, sipas dhe në përputhje me programin e ESAF-it dhe gjitha marrëveshjet e tjera me FMN-në, financimin grant, marrëveshjen e kredisë me IDA-n dhe të gjitha kontratat e punimeve civile që lidhen me Projektin dhe gjithë projektin e Transporteve të IDA-s.

Seksioni 3.02 Njësia e Zbatimit të Projektit

Huamarrësi do ta përdorë PIU-n për të kordinuar, menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, përfshirë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve për Projektin. Huamarrësi do të mbajë, përveç kur bie dakord ndryshe me Bankën, PIU-n gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të Projektit dhe do të operojë PIU-n me burimet e nevojshme dhe personel të përshtatshëm dhe të kualifikuar, përfshirë së fundi një konsulent të huaj, sipas termave të referencës të miratuara nga Banka. Pa u kufizuar sa më sipër, detyrimet e Huamarrësit, sipas Seksionit 3.02, nuk do të kenë efekte në termat ose amendamentet e Marrëveshjes së Kredisë së IDA-s.

Seksioni 3.03 Prokurimet

Për qëllime të Seksionit 4.03 të Termave Standarde dhe Kushteve, klauzolat e mësipërme, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, do të rregullojnë prokurimet e mallrave, punëve dhe shërbimeve të kërkuara në Projekt dhe të financuara nga Huaja:

a) Mallrat, punët dhe shërbimet (përfshirë shërbimet e konsulentëve, të cilët janë përfshirë në nënseksionin (c) do të prokurohen me tender të hapur.

b) Për qëllim të nënseksionit (a), procedurat për tenderin e hapur janë bërë të ditura në Kapitullin 3 të Rregullave të Prokurimeve të EBRD.

c) Këshilltarët, të zënë në punë nga Huamarrësi që ndihmojnë në ecjen përpara të Projektit, do të zgjidhen në përputhje me procedurat të bëra të ditura në Kapitullin 5 të Rregullave të Prokurimit të EBRD.

d) Gjithë kontratat do të jenë subjekt rishikimi procedural, siç bëhet e ditur në Lidhjen 1 të Rregullave të Prokurimit të EBRD.

c) Kontratat e mëposhtme do të jenë subjekt i rishikimeve përpara se të lidhen:

(i) kontratat e mallrave, punëve dhe shërbimeve (duke përjashtuar shërbimin konsulent që është mbuluar më pas në pikën (ii), vlerësuar me një kosto të barabartë me 100.000 Euro ose më shumë, dhe

(ii) kontratat për shërbime këshillimore, vlerësuar me një kosto të barabartë me 100.000 Euro ose më shumë.

Seksioni 3.04 Angazhimet lidhur me mjedisin

Pa kufizuar përgjithësinë e Seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të Termave Standarde dhe Kushteve, Huamarrësi do të :

a) garantojë që përputhshmëria e punimeve me rregullat e mjedisit të identifikuar nga konsulentët që kryejnë pjesën B-1 të Projektit të zbatohet.

b) Gjatë ekzekutimit të punimeve në përputhje me Projektin do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të gjitha vendndodhjet e Projekteve janë menaxhuar në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe këto:

(ii) hapa janë ndërmarrë për drejtimin e trafikut dhe minimizimin e shqetësimeve të njerëzimit;

- (iii) masa paraprake janë marrë që të garantohet sigurimi i punëtorëve dhe përdoruesit të rrugëve;
- (iv) zhurmat dhe ndërhyrjet janë minimizuar; dhe
- (v) publiku është i mirëinformuar rreth punëve të propozuara.

Seksioni 3.05 Konsulentët

Në mënyrë që të ndihet në zbatimin e Projektit, Huamarrësi do marrë, përveç nëse bihen dakord ndryshe me Bankën, të punësojë ose të sjellë për të punuar, si dhe përdorë konsulentët që kanë kualifikimin, eksperiencën dhe të përcaktuar nga termit e referencës së Bankës përfshirë.

(j) Konsulentët do të ndihmojnë në zbatimin e punëve të parashtruara në pjesën B-1 të Projektit; dhe

(j) Konsulentët do të ndihmojnë në zbatimin e punëve të parashtruara në pjesën B-2 të Projektit.

Seksioni 3.06 Shpeshtësia e raportimit dhe kërkesat e dorëzimit

a) Ndërsa Projekti të përfundojë, Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës raportin vjetor mbi ambientin, siç referohet në Seksionin 4.04(a) (3i) të Termave Standarde dhe kushteve, përfshirë masat për sigurimin dhe shëndetin e punëtorëve në lidhje me Projektin. Ky raport do të dorëzohet brenda 120 ditësh pas mbylljes së vitit raportues dhe do të përfshijë këto karakteristika specifike:

i) ndonjë ndryshim në ligjet dhe rregulloret që zbatohen për mjedisin dhe

ii) ndonjë rast të mospërputhjes me ligjet dhe rregulloret që zbatohen, duke përfshirë çdo veprim ligjor që përfshin Huadhënësin ose Projektin.

b) Raporti periodik i Projektit, i parashikuar në Seksionin 4.04 (a) (iv) të Termave dhe Kushteve Standarde do të paraqitet çdo tremujor brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës që është raportuar, derisa projekti të përfundohet. Këto raporte do të përfshijnë të dhënat specifike të mëposhtme:

i) informacionet e përgjithshme të mëposhtme:

1) progresin fizik të përfunduar në zbatimin e Projektit deri në datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

2) progresin në zbatimin e përputhjes së punëve me kërkesat mjedisore, sipas Seksionit 3.04 (a);

3) vështirësitë e mundshme dhe vonesat në zbatimin e Projektit dhe efektet e tyre në zbatimin e skedulit dhe hapat aktuale të ndërmarra ose të planifikuara për kalimin e vështirësive dhe shmangien e vonesave;

4) ndryshimet e pritshme në datën e përfundimit të Projektit;

5) ndryshimet kryesore të personelit në stafin e PIU-t, këshilltarëve ose furnizuesve;

6) çështjet që ndikojnë në koston e Projektit, dhe

7) çdo zhvillim ose aktivitet që ka të ngjarë të ndikojë në zbatueshmërinë ekonomike të ndonjë pjese të Projektit.

ii) a bar –tipe progress chart, bazuar në skedulën e zbatimit të projektit të rënë dakord midis Bankës dhe Huamarrësit gjatë ose përpara ekzekutimit të kontratave të punimeve civile për pjesë A1 të projektit, duke përfshirë një grafik shpenzimesh aktual dhe të planifikuar.

iii) pasqyrat financiare që tregojnë detajet e shpenzimeve të kryera nga secila palë e Projektit dhe zvogëlimi i Huasë së bashku me një pasqyrë që tregon:

- (1) vlerësimet e vlerës fillestare;
- (2) vlerësimet e vlerës së rishikuar, nëse ka ndonjë me shkaqet e ndryshimeve;
- (3) shpenzimet fillestare të vlerës deri tani;
- (4) shkaqet për ndryshimet e pikës 3 (të mësipërme nga shpenzimet aktuale); dhe
- (5) vlerësimet e llogaritura për mbetjen e tremujorit të vitit.

(iv) një pasqyrë të statutit, në përputhje me një nga angazhimet e Marrëveshjes së Huasë.

c. Derisa Projekti të ketë përfunduar, Huamarrësi, do t'i dorëzojë Bankës të gjitha raportet e mbajtura nga IDA, përfshirë në Marrëveshjen e kredisë së IDA-s, dhe kopjet e të gjitha raporteve të mbajtura për FMN-në ose IDA-n për Projektin Korridorin Lindje-Perëndim.

Neni 4 **Angazhimet financiare**

Seksioni 4.01 Regjistrimet financiare dhe raportet

a) Huamarrësi do të mbajë parasysh në lidhje me departamentet dhe agjensitë e Huamarrësit që përgjigjen për zbatimin e Projektit nga njëra anë, procedurat, rakordimet dhe llogaritë të pasqyrohen në përputhje me standardet e miratuara të kontabilitetit të aplikuara, operacionet, burimet dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me Projektin dhe të monitorojë dhe rakordojë zhvillimin e Projektit (përfshirë aty koston dhe përfitimet që do të rrjedhin nga to).

Huamarrësi:

k) do të ketë rakordimet dhe llogaritë referuar në paragrafin a) të këtij Seksioni për çdo vit fiskal të audituar, në përputhje me parimet e miratuara të auditimit dhe të aplikuara rigorozisht me auditor të pavarur të miratuar.

iii) furnizon Bankën sa më shpesh, por në ndonjë rast jo më vonë se 4 muaj pas përfundimit të vitit fiskal, raportet të cilat auditohen sa herë që mbikqyrësi ka mundësi dhe në disa banka kthen përgjigje dhe

iv) furnizon Bankën me më shumë informacion, përmbledh rakordimet dhe llogaritë të audituara më së miri dhe Banka kthen përgjigje herë pas here.

Neni 5 **Pezullimi**

Seksioni 5.01. Pezullimi

Sa vijon, janë specifikuar për qëllim të Seksionit 7.01 (a) (iv) të Termave Standarde dhe Kushteve:

a) E drejta e Huamarrësit të tërheqë fondet e Iniciativës së Europës Qendrore ose Qeveria Italiane do të jetë pezulluar, anuluar ose mbaruar në përgjithësi ose me një pjesë në pajtim me termat e organizimit relevant. Miratohet, sidoqoftë, se klauzolat e këtij paragrafi nuk do të aplikohen n.q.s. Huamarrësi vendos të përmbushë këtë grand ose kredi financiare të mjaftueshme të miratojë fondet e nevojshme Projektin janë të vlefshme të marra nga Huamarrësi nga Burime të tjera në terma dhe kushte të ngjashme me burimet e Huamarrësit mbi këtë Marrëveshje.

b) Për ndonjë arsye, financimi i fondeve i vlejnë Huamarrësit të paguajë koston e Projektit në më pak se 35 të totalit të vlerësimit të koston.

c) për ndonjë arsye, të drejtat mbi tokën, të nevojshme për implementimin e pjesës A-2 të Projektit, nuk janë fituar nga Huamarrësi dhe nuk i janë vënë në dispozicion kontraktorëve të përshkruar në seksionin 6.01 (b) në ose përpara 31 dhjetorit 2000.

Neni 6 **Efektiviteti**

Seksioni 6.01 Kushtet paraprake për efektivitetin

Këto janë specifikuar për qëllim të Seksionin 9.02 (c) të Termave Standarde dhe Kushteve si kushtet plotësuese të efektivitetit të kësaj Marrëveshje:

a) Banka duhet të jetë furnizuar me evidencë e ratifikimit të Marrëveshjes nga Parlamenti.

b) Banka duhet të jetë furnizuar me evidenca ku Huamarrësi të ketë hyrë në lidhje me kontraktuesit, në formë dhe në përmbajtje për punimet civile përfshirë në pjesën A të Projektit.

c) Banka duhet të furnizohet me evidencën mbi të drejtat e tokës së nevojshme për zbatimin e pjesës A 1 të Projektit janë siguruar nga Huamarrësi dhe janë bërë të vlefshme për kontraktuesit në kontratat në paragrafin (b).

d) Banka duhet të furnizohet me evidencë se e drejta e Huamarrësit të tërheqë fondet e Iniciativës së Europës Qendrore është bërë efektive dhe

e) Banka duhet të furnizohet me evidencë se e drejta e Huamarrësit për të tërhequr fondet e Qeverisë Italiane është bërë efektive.

Në lidhje me kërkesat e parashtruara, evidencat e që duhet të furnizohet Banka duhet të përmbushin kërkesat e saj në formë dhe përmbajtje.

Seksioni 6.02 Opinioni ligjor
Për qëllime të Seksionit 9.03 të Termave Standarde dhe Kushteve, opinionit ose opinionet ligjore do të jepen në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03 Kushtet e disbursimit të Huasë.
Ndonjë tërheqje të huasë do të varet nga kushti që kjo Marrëveshje të jetë bërë efektive.
Seksioni 6.04 Mbarimi i Marrëveshjes për shkak se nuk është bërë efektiv
Data një vit pas datës së Marrëveshjes është specifikuar për qëllim në seksionin 6.04 të Termave Standarde dhe Kushteve.

Neni 7 **Të ndryshme**

Seksioni 7.01 Shënime
Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllim të seksionit 10.01 të Termave Standarde dhe Kushteve:
Për Huamarrësin;
Ministri i Financave
Adresa: Bul Dëshmorët e Kombit
Tiranë
Në vëmendje Ministrit të Financave
Fax: 355 42 284 94
Për Bankën:
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EG2A2JN
UK
Attention: Operation Administration Unit
Fax: 44 20 73386100
Telex: 881261
Answerback: EBRDLG

Në dëshmi të kësaj, Palët këtu, duke vepruar me përfaqësuesit e tyre, përkatësisht të autorizuar bëjnë që kjo Marrëveshje të firmoset në katër kopje dhe dërgohet në (Londër, Angli) në datën dhe vitin e shkruar sipër në fillim.

Republika e Shqipërisë

Banka Europiane për rindërtim dhe zhvillim

Ministria e Punëve të Jashtme
Drejtoria Juridike, Konsullore dhe e Traktateve

Skeduli 1 – Përshkrimi i Projektit

1. Qëllimi i Projektit është (I) të ndihmojë Huamarrësin të zbatojë një program për ripartimin, rehabilitimin dhe të sigurojë përmirësimin e mbi përafërsisht 30.5 km në rrugën Lindje-Perëndim Korridori Elbasan-Librazhd, (ii) për të reduktuar koston operative të mjeteve të transportit nëpërmjet parandalimit të shkatërrimit të shkaktuar nga cilësia e dobët e sipërfaqeve të rrugëve (iii) të ulë numrin e aksidenteve rrugore dhe dëmtimeve serioze përmes sigurimit të përmirësimeve, (iv) të zhvillojë konkurrencën e pjesëmarrësve të punimeve të rrugëve përmes tenderit të hapur, (v) të përmirësojë transportin rrugor që kompletin seksionin Lindje-Perëndim të Korridorit Rrugor që lidh territorin e Huamarrësit me Republikën e ish-Jugosllavisë të Maqedonisë dhe Greqinë (EU Korridori VIII) dhe (vi) të ulë vonesat në lëvizjen e ndihmave për në kufirin e Maqedonisë për të ndihmuar në rindërtimin e Kosovës.

2. Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme, subjekt për modifikim, si nga Banka dhe Huamarrësi, duke rënë në ujdi herë pas here.

Pjes A: Programi i investimeve:

A-1 Përmirësimi në afërsisht 22.5 km sektor të rrugës Elbasan –Librazhd në një rrugë 7.5 m carriage way me një shtesë 5 cm asfalti me dy krahë prej 1.5 m.

A-2 Përmirësimi në afërsisht 8.0 km seksion i rrugës Elbasan –Librazhd në një rrugë 7.5 m të gjerë me 5 cm asfalt me dy krahë 1.5 m.

Pjesa B: Zbatimi

B-1 Rishikimi i hartimit të detajeve dhe dokumenteve të tenderit për pjesën A të Projektit.

B- 2 Mbikqyrja e punimeve të ndërtimit në Pjesën A të Projekt.

3. Projekti është parashikuar të përfundojë me 30 Dhjetor 2002.

Skeduli 2: Kategoritë dhe tërheqjet

1. Tabela, bashkëngjitur, tregon kategoritë dhe zërat që do të financohen nga kjo Hua, alokimin e shumave për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar.

2. Megjithë dispozitat më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me:

a) pagesa të bëra për shpenzime para datës të Marrëveshjes së Huasë dhe

b) shpenzime të bëra nën kategorinë 1, derisa Banka të ketë aprovuar kontratat për punët civile të caktuara në pjesën A të Projektit.

Kategoria	Shuma e Huasë e alokuar në Euro	% e shpenzimeve për t'u financuar
	9,9 milion	100% e vlerës së kontratës
1. Punime për pjesën A-1 të Projektit	0.1 milion	100% e komisionit
2. Komisioni Front-End	10 milion	
Totali		

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 15.6.2001
Doli nga shtypi më 18.6.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë